Të gjithë zëra në Formularin e listës së çmimeve sipas zërave të preventivit dhe grafikut të realizimit të punimeve duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar për secilin zë në preventiv. Zërat e preventivit pa vlerë do të konsiderohen si zëra të paofertuar dhe do të çojnë në refuzimin e ofertës.

Oferta ekonomike e detajuar

Nr	Nr. Analizë	Përshkrimi i Punëve	Njësi	Sasia	Çmimi/ Njësi	Cmimi total
1.						
2.						
3.						
Shuma						
Fondi Rezervë						
Shuma						
TVSH						
SHUMA TOTAL						

Nënshkrimi i ofertuesit _____

Vula

Shënim: Çmimet duhet të shprehen në Monedhën ____ (e kërkuar në dokumentat e tenderit)

Shtojca 3.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: *[Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]*

Në emër të: *[Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]*

* * *

Procedura e prokurimit *[lloji i procedurës]*

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[objekti]*

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike *[Data]* *[Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-së*

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e *[emri i autoritetit /entit kontraktor]* vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në *[njoftimin e kontratës]*.

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 4.

(Shtojce për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 5.

[*Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor*]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Të dhënat teknike të punëve objekt prokurimi duhet të përshkruhen sa më saktë dhe në mënyrë të plotë, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi.

SHËNIM: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet /entet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

- a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për eficientësinë e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;
- b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit në mjedis;
- c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Shtojca 6.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

GRAFIKUT I ZBATIMIT TË PUNIMEVE

Afatet e realizimit të punimeve: 12 MUAJ

<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3.Afati i realizimit</i>				
Nr	Përshkrimi i Punëve	Java 1/Muaji 1	Java 2/Muaji 2	Java 3/Muaji 3	Java 4/Muaji 4	Java 5/Muaji 5
1.						
2.						
3.						
4						

Shënim. Autoriteti/enti kontraktor mund të shtojë rreshta në varësi të zërave të punimeve dhe kollona në varësi të afatit të parashikuar për realizimin e tyre.

Shtojca 7.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

OFERTUESI DEKLARON SE:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) nuk ka pagesa të pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërket për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë;
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi;
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi;
- j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi;
- k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërket për Operatorët Ekonomikë, të regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, **sipas Shtojcës 8.**

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/Enti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme përvërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një Bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet:

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit/entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

Sipas percaktimeve të bera në Shtojcën 7 të DST-ve **(Kriteret e Përgjithshme të Përzgjedhjes/ Kualifikimit).**

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1. Për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm Operatori ekonomik duhet të paraqesë Kopje të certifikuara të bilanceve të 3 (tri) viteve të fundit financiare (2022, 2023, 2024) të paraqitur në Autoritetet përkatëse Dega e Tatim Taksave të konfirmuara nga ky Autoritet si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit). Shënim: Akt Ekspertizë e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, duhet të paraqitet nga OE vetëm në rastin kur janë në kushtet e percaktimeve të nenit 41, gërma “c” të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar.

2. Kopje të deklarimit të xhiros vjetore gjatë 3 (tri) viteve të fundit financiare (2022, 2023) lëshuar nga Autoriteti përkatës, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e parashikuar e kontratës që po prokurohet konkretisht: **81,806,257.3 (tetedhjetë e njemilion e teteqind e gjashtëmijë e dyqind e pesëdhjetë e shtatë presje tre)** lekë pa TVSH (*Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse Operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor*).
3. Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2024 sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, (i ndryshuar). Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB. (*Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotesimin e formularit të vetedeklarimit, dokumentet përkatëse vërtetuese do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit*).

2.3 Kapaciteti teknik:

Përsa i përket aftësisë teknike e profesionale, Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale të cilat vendosen nga Autoriteti Kontraktor si më poshtë:

1. Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:

- a. Punë të ngjashme për një objekt të vetëm me vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përllëguar të kontratës që prokurohet konkretisht: **40,903,128.64** lekë pa TVSH, të realizuar gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.
- b. Punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit është në një vlerë jo më të vogël sa dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet konkretisht: **163,612,514.58** lekë pa TVSH.

Plotesimi i njerit prej dy kushteve të sipërpermendura e ben oferten te kualifikueshme.

Pika 1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Në rastin kur Operatorët ekonomik, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në Kontratën e Bashkëpunimit se cili prej tyre do ta përmbushë këtë kusht.

1.2 Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:

- a) Për kontrata të realizuara me ente publike, Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
 - Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9 (ku të përcaktohet qartazi vlera, afati i përfundimit të kontratës si dhe natyra e punës së kryer);
 - Kontratë Sipërmarje;
 - Situacionin përfundimtar;
 - Aktin e kolaudit;

- Çertifikaten e marrjes ne dorezim/Çertifikatën e Përkohshme të marrjes ne dorezim.
- b) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
 - Formular vleresimi per realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9 (ku të përcaktohet qartazi vlera, afati i perfundimit te kontrates si dhe natyra e punes se kryer);
 - Kontrate Sipërmarrje;
 - Situacionin përfundimtar;
 - Aktin e kolaudimit;
 - Çertifikaten e marrjes ne dorezim/ Çertifikatën e Përkohshme të marrjes ne dorezim;
 - Fatura tatimore perkatese te **Deklaruara ne organet tatimore.**

1.3 Per kontratat e realizuara si Bashkim Operatoresh, Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqesë: Kontraten e Bashkimit te operatoreve ekonomik si dhe prokuren e posacme te deklaruar ne fazen e tenderimit.

1.4 Për kontratat e realizuara si nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet te paraqesë: kontratën baze ndermjet kontraktorit dhe autoritetit kontraktor, kontraten e nenkontraktimit dhe aktin e miratimit zyrtar si nenkontraktor.

2.3.2 Liçensa profesionale, lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës:

Operatori Ekonomik duhet te disponoje Liçencë të shoqërisë e vlefshme për kategoritë e mëposhtme:

Për punimet e përgjithshme të ndërtimit kompania duhet të ketë liçensat e mëposhtme:

- | | | |
|-----------------|--|-----------------|
| • N.P-1 | (Punime germimi e toke) | Niveli A |
| • N.P-2 | (Ndërtime civile dhe industriale) | Niveli A |
| • N.P-3 | (Rikonstuksion dhe mirembajtje,) | Niveli A |
| • N.P-7 | (Ujësjellës, gazsjellës, vajsjellës, vepra kullimi e vaditje) | Niveli A |
| • N.P-11 | (Ndërtime për nënstacione, kabinat e transformacionit linjat e T/N dhe tensionit të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë.) | Niveli A |

Për punimet speciale të ndërtimit duhet të ketë liçensat e mëposhtme:

- | | | |
|------------------|---|-----------------|
| • N.S.-1 | (Punime per prishjen e ndertimeve) | Niveli A |
| • N.S.-2 | (Impiante hidrosanitare,) | Niveli A |
| • N.S.-4 | (Punime rifiniture te muratures,) | Niveli B |
| • N.S.-8 | (Ndërtime parafabrikat betonarme, struktura metalike dhe druri) | Niveli A |
| • N.S.-12 | (Impiante Teknologjik, termike,) | Niveli A |
| • N.S.-14 | (Impiante te brendshme, elektrik,) | Niveli A |
| • N.S.-18 | (Punime topogjeodezike,) | Niveli A |

sipas modelit të lëshuar nga institucioni përgjegjës për dhënien e licensave profesionale sipas legjislacionit në fuqi.

Operatorët e huaj duhet të barazvlerësojnë (ekuivalentojnë) licencat profesionale që ata kanë lëshuar nga vendi i origjinës, në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, (ose Ministrinë

kompetente) në Republikën e Shqipërisë. (Rregullore për kriteret dhe procedurat për lëshimin e licencave profesionale për zbatimin, klasifikimin dhe disiplinimin e personave juridikë që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, miratuar nga VKM, Nr. 42, datë 16.01.2008).

2.3.3 Operatori Ekonomik duhet të jete i licensuar nga QKB me

a. **Licencë kategoria III.2.B për “Grumbullim, transportim, ruajtje/magazininim, rikuperim të mbetjeve të llojeve të ndryshme”**

(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, licencat e mesiperme duhet të disponohen nga ana anetari që do të kryejë shërbimet perkatëse).

2.3.4 Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf inxhinierik për kryerjen e të gjitha punimeve në objekt, të përfshirë në licencën e shoqërisë, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, librezë pune, diplomë përkatëse si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, konkretisht:

- Minimuni 1 (një) **Inxhinier Ndërtimi**
- Minimuni 1 (një) **Inxhinier Hidroteknik**
- Minimuni 1 (një) **Inxhinier Elektrik**
- Minimuni 1 (një) **Inxhinier Topograf/Gjeodet/Markshejder**
- Minimuni 1 (një) **Arkitekt**

-Operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt sipas Udhëzimi Nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”.

-Operatori ekonomik duhet të deklarojë se Drejtuesit Teknik të mesiperm janë të punësuar në përputhje me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”.

Per drejtuesit Teknik të kërkuar të paraqitet:

- i. Libreze pune (përkatëse)
- ii. C.V (përkatëse)
- iii. Kontrate pune e vlefshme (përkatëse)
- iv. Diplomë

(Në rastin e Bashkimit të Operatoreve Ekonomik secili Operator duhet të plotësojë pikat dhe deklaratat e mesiperme në varesi të vlerës dhe zerave të preventivit të punimeve që ka marrë për sipër sipas përqindjes së bashkëpunimit).

(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetedeklarimit dhe deklaratave të mesiperme, dokumentet përkatëse vërtetuese do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit).

Shenim : Në formularin përmbledhës të vetedeklarimit, Deklarata B, operatorët ekonomik duhet të deklarojnë për inxhinieret e mesiperm, emer/mbiemer, atesia,

numrin personal te ID , numrin dhe titullin e kualifikimit per diplomën përkatëse, si dhe institucionin qe ka leshuar kete dokument.

2.3.5 Operatori ekonomik, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe **stafin mbështetës** (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), si më poshtë:

- Inxhinier Ndertimi - 1 (nje)
- Inxhinier Mekanik - 1 (nje)
- Inxhinier Elektronik - 1 (nje)

Ne rastin e bashkimit te operatoreve ekonomik, cdo anetar i grupit duhet te paraqese punojesit e mesiperm, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

Inxhinierët e sipërcituar duhet të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë per 3 (tre) muajt e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave. Për inxhinierët duhet të paraqiten:Diploma, Kontratë individuale pune (e vlefshme),librezë pune, C.V.

Për plotësimin e kësaj kërkesë operatori ekonomik duhet të vetëdeklarojë personelin e mësipërm në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8, ndërsa përpara lidhjes/nënshkrimit të kontratës operatori ekonomik fitues duhet të dorëzojë për personelin inxhinier të sipërcituar dokumentacion e lart përmendur

2.3.6 Operatori/et ekonomik duhet të kenë në stafin e tyre personel të kualifikuar/çertifikuar si:

- a) **1 (një)** punonjes i pajisur me çertifikate “**Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave**” e cila të jetë e lëshuar nga shoqeri të akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplome/certifikate, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë minimumi per 3 (tre) muajt e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave. *(Në rastin e Bashkimit të Operatorëve ekonomikë, secili prej Operatorëve duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) punonjës "Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave")*.
- b) **1 (një)** punonjës me çertifikatë "**Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit në punë**" në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr. 10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M Nr. 312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier", shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplome/certifikate, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë minimumi per 3 (tre) muajt e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave. *(Në rastin e Bashkimit të Operatorëve ekonomikë, secili prej Operatorëve duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (nje) punonjës "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit në punë")*.
- c) **1 (nje)** inxhinier si “**Ekspert zjarrfikës**” në përputhje me pikën 4, të nenit 49, të Ligjit Nr.152/2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”. Per kete duhet te paraqitet Certificate/deshmi per ekspert zjarrfikës te leshuar nga Ministria e Puneve te Brendeshme, diploma dhe kontrata noteriale e punes si dhe të rezultojë në listpagesat e shoqërisë per 3 (tre) muajt e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave. *Ne rast se oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh ky kriter plotesohet nga anetari qe do te kryeje punimet e MNZ.*
- d) **3 (tre)** Punonjes **Specialist te Certifikuar dhe trajnuar per Punimet ne lartesi**

D.P.I. Renia nga lartosite, punime ne fasade, etj sipas V.K.M nr.312 date 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier” e dhenë nga një organizate certifikimi e akredituar shqiptar ose e huaj. Per keto duhet të paraqitet :certifikata/dëshmi trajnimit e dhënë nga një organizëm i licencuar/certifikuar certifikimi shqiptar ose i huaj, kontratë pune e vlefshme si dhe të rezultojnë në listpagesat e shoqërisë per 3 (tre) muajt e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave *(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotesimin e formularit te vetedeklarimit dhe deklarave te mesiperme, dokumentet përkatëse vërtetuese do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit).*

2.3.7 Operatori ekonomik duhet te kete nje punesim mesatar minimumi **45 (dyzet e pese)** punonjes te vertetuar me: Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve minimumi per 3 (tre) muajt e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave dhe listpagesat perkatese të konfirmuara nga autoritetet përgjegjese, shoqëruar me formularët e deklarimit të pagesave për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore. *(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotesimin e formularit të vetedeklarimit, dokumentet perkatese vertetuese do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit).*

2.3.8 Operatori ekonomik duhet të disponojë **punonjës të specializuar/të kualifikuar**, si dhe të përfshirë në listepagesa për periudhën 3 muajt e fundit, me profesionet si mëposhtë:

- 1 (një) Teknik ndertimi
- 2 (dy) Specialist ndertimi
- 1 (nje) Specialist IT
- 2 (dy) punonjes hidraulik
- 5 (pese) punonjes elektrikist
- 2 (dy) punonjes bojaxhi
- 1 (nje) punonjes muratore
- 7 (shtate) punonjes murature/suvatues
- 2 (dy) punonjes termoizolues
- 2 (dy) punonjes hidroizolues
- 2 (dy) punonjes per punime durale
- 2 (dy) punonjes per punime gipsi
- 4 (kater) punonjes pllakashtrues
- 1 (nje) punonjes shtrues parketi
- 3 (tre) punonjes specialist per ngrohje-ftohje
- 1 (nje) punonjes karpentier
- 1 (nje) punonjes betonues
- 1 (nje) punonjës specialist per konstruksione metalike
- 1 (nje) punonjës saldator
- 1 (nje) punonjës mekanik
- 2 (dy) punonjes mobiliere

Krahas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës perkatese në DST, për punonjësit me profesionet si më sipër, operatorët ekonomikë duhet të plotësojnë dhe të paraqesin tabelën me të dhënat si më poshtë:

Nr.	Emër Mbiemër I punonjësit	Profesioni	Institucioni 27onfor/privat lëshues I certifikatës/diplomës	Nr NIPT (Në rast se lëshuesi është institucion privat)	NR AMZES
1.					
2.					
etj.					

* Disponimi i stafit/ punonjësve sipas specialitetit të kërkuar, duhet të deklarohet nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës perkatese në DST, si dhe *në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit*, për secilin punonjës, duhet të paraqesë dokumentacionin: Për specialistët e sipercituar sipas profesioneve, duhet të paraqiten, deshmitë/certifikatat ose cdo dokument tjetër që verteton diplomimin/trajnimin/ose kualifikimin e tyre sipas profesionit, si dhe kontratat individuale të punës të vlefshme.

- Kontrata e punës e vlefshme,
- Dëshmi/ certifikatë kualifikimi të lëshuara nga institucione publike/ private të licensuara për kurset e ofruara, sipas ligjit nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë” për specialistët, ndërsa për teknikët duhet të paraqiten diplomat e shkollës së mesme/ ose te larte,
- Secili specialistë i sipercituar sipas profesioneve, duhet të figurojë në listëpagesat e shoqërisë për të paktën 3 muajt e fundit, nga data e zhvillimit të tenderit.

2.3.9 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojë në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës perkatese në DST, se ka pjesë të stafit të punësuar minimumi 2 (dy) shoferë dhe 2 (dy) manovratorë (1 automakinist dhe 1 eskavatorist) , të cilët duhet të figurojnë në listëpagesa të shoqërisë në rastin kur mjetet/makineritë e deklaruar janë në pronësi të operatorit ekonomik ofertues, në të kundërt kur mjetet/ makineritë disponohen me qera, ky staf i kërkuar mund të jetë i kontraktuar, **dhe në çdo rast, në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, për secilin të paraqiten:**

- Kontratë pune të vlefshme,
- Dëshmi kualifikimi nga organet përkatëse sipas ligjit,
- Për stafin manovratorë/automakinist të paraqiten: Dëshmi e aftësisë profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda të ndërtimit dhe punimeve në tokë (të vlefshme) lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor;

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

2.3.10 Ne perputhje me specifikimet teknike si dhe preventivit perkates, operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim/kontrate bashkepunimi nga prodhuesi/distributori, me të cilin prodhuesi/distributori autorizon kompaninë pjesëmarrëse në tender të ofertojë këto pajisje/mallra në këtë procedurë prokurimi, si më poshtë:

- Materiale elektrike
- Materialet hidraulike
- Materialet e sistemit te mbrojtjes kundra zjarrit (MNZ)
- Materiale te sistemit te ngrohjes HVAC
- Materiale hidroizoluese, llac, fino, kolle
- Materiale termo-izoluese (Sistem Kapote)
- Pajisje hidrosanitare
- Pllaka, Parket,
- Bojra
- Mobilim (karrige dhe tavolina)

Për rastin kur autorizimi dotë jetë lëshuar nga distributori i autorizuar, duhet të shoqërohet edhe me dokumentacionin (kontratë/autorizim) që vërteton lidhjet e firmës prodhuese me distributorin

Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

2.3.11 Ne perputhje me specifikimet teknike si dhe preventivin perkates për produktet e mëposhtme duhet te paraqiten:

PUNIMET ELEKTRIKE

Kabell FG16M16 Kabllot FG16M16-0,6/1 duhet te jene sipas standardeve: CEI 20-13 IEC 60502-1 ose ekuivalente, CEI UNEL 35318-35322-35016 ose ekuivalente; EN 50575:2014 + EN 50575/A1:2016 ose ekuivalente. Fleksibiliteti i bakrit duet te jete i klasit 5. Tensioni nominal U_0 duhet te jete 600V (AC). Tensioni nominal U duhet te jete 1000V(AC). Tensioni i tetimit duhet te jete 4000V. Tensioni maksimal U_m duhet te jete 1200V(AC). Temperatura maksimale e operimit duhet te jete 90 °C. Temperatura maksimale e lidhjes se shkurter duhet te jete 250 °C per seksione deri ne 240mm² Temperatura minimale e operimit duhet te jete -15 °C. Forca maksimale ne terheqje nuk duhet te jete me pak se 50N/mm². Duhet te paraqiten: Skedat teknike/kataloge te shoqeruara me raportet e testimit nga laboratore te akredituar ose certifikata aprovimi/performance

Percjelles FS-17, me izolim PVC, djeg.pa flake dhe emetim gazi, $U_n=450/750$ V. Kabllot N07V-K apo te njohur me kodin e ri FS17 450/750V duhet te jene sipas standardeve CEI 20-14, CEI UNEL 35716-35016 ose ekuivalente, CEI EN 50525 ose ekuivalente, EN 50575:2014 + EN 50575/A1:2016 ose ekuivalente. Fleksibiliteti i bakrit duet te jete i klasit 5. Tensioni nominal U_0 duhet te jete 450V dhe tensioni nominal U duhet te jete 750V. Tensioni i testimit duhet te jete 3000V ndersa tensioni maksimal duhet te jete 1000V. Temperatura maksimale e operimit duhet te jete 70 °C. Temperatura maksimale e lidhjes se shkurter duhet te jete 160°C. Temperatura minimale e operimit

duhet te jete -10 °C dhe temperature minimale e instalimit duhet te jete 5°C. Duhet te paraqiten: Skedat teknike/kataloge te shoqeruara me raportet e testimit nga laboratore te akredituar ose certifikata aprovimi/performance

Automat; Ndërprerës termo-magnetik për kontroll, numri i poleve 2 dhe 4, Kurba e kycjes: C., Rrymat maksimale te shkycjes (Icu) : 10kA, Tensioni i izolimit duke u bazuar ne standartin IEC/EN 60664-1 ose ekuivalente: 440 V. Frekuenca 50/60 Hz. Tipi i mbrojtjes: IP20 Te plotesoje Standartin IEC / EN 60898-1 ose ekuivalente dhe IEC/EN 60947-2 ose ekuivalente. Duhet te paraqiten: Skedat teknike/kataloge te shoqeruara me raportet e testimit nga laboratore te akredituar ose certifikata aprovimi/performance

Prize 2P+T/16A Te plotesoje standartin CEI 23-50-II ose ekuivalente. Duhet te paraqiten: Skedat teknike/kataloge te shoqeruara me raportet e testimit nga laboratore te akredituar ose certifikata aprovimi/performance

Ndriçues luminishent Me driver LED te integruar. Fluksi i ndricimit: 85lm/w. Eficensa e ndricimit: 120lm/W Te plotesoje Standartin EN 60598 ose ekuivalente. Duhet te paraqiten:Kataloget/skedat teknike te shoqeruara me raportet e testimit nga laboratore te akredituar ose ekuivalente

PUNIME BOJATISJE

Bojë AkrilikeProdukti duhet te përmbushë specifikimet teknike në përputhje me Standardin SSH: EN ISO 16000-9 ose ekuivalente, lidhur me emetimin e komponenteve organike te paqëndrueshem (VOC), ku emetimi te jete jo më poshtë se KLASA “A+”, si dhe T.V.O.C<1000µg/m³. - ISO 6504-3 ose ekuivalente, lidhur me aftesine mbuluese te bojës, ku fuqia mbuluese te jete ISO 11998 ose ekuivalente lidhur me rezistencen ndaj larjes. Duhet te paraqiten:Kataloget/skedat teknike te shoqeruara me raportet e testimit nga laboratore te akredituar me ISO 17025 ose ekuivalente. Certifikim ku të vërtetohet se produkti është boje ekologjike.

Bojë Hidroplastike ku të vërtetohet se produkti përmbush specifikimet teknike në përputhje me Standardin SSH: EN ISO 16000-9:2006/AC:2007 ose ekuivalente, lidhur me emetimin e komponentëve organikë të paqëndrueshëm (VOC), ku emetimi të jetë jo më poshtë se KLASA “A+”, si dhe T.V.O.C < 1000µg/m³. - SSH EN ISO 6504-3:2007 ose ekuivalente, lidhur me aftësinë mbuluese (fshehëse) të bojës, ku fuqia mbuluese të jetë jo më pak se Klasa e I-rë.- SSH EN ISO 11998:2006 ose ekuivalente lidhur me rezistencën ndaj fërkimit të lagësht, ku rezistenca ndaj fërkimit të lagësht të jetë jo më pak se Klasa e II-të. Duhet te paraqiten:Kataloget/skedat teknike te shoqeruara me raportet e testimit nga laboratore te akredituar me ISO 17025 ose ekuivalente Certifikim ku të vërtetohet se produkti është boje ekologjike dhe antibakteriale.

PUNIME SHITESH

Hidroizolues Material dykomponentesh me baze çimento dhe hidroizolues, elastik me funksion mbrojtës për tarrace, themele, bodrume, etj. Produkti duhet te përmbushë specifikimet teknike në përputhje me Standardin SSH EN 14891:2017 ose ekuivalente, lidhur me produktet e lëngshme të papërshkueshme nga uji. Duhet te paraqiten:Kataloget/skedat teknike te shoqeruara me raportet e testimit nga laboratore te akredituar me ISO 17025 ose ekuivalente

Kolle Speciale Antilagështirë Ngjitës thiksotropik, elastik, i gatshëm për përdorim, me bazë shpërndarjen ujore të estereve poliakrilike dhe shtesa të veçanta kategoria D2TE sipas EN 12004 ose ekuivalente. Rezistent ndaj lagështisë, acideve të holluara, sipërfaqeve alkalike. Rezistencë të madhe fillestare dhe përfundimtare në ngjitje. Pesha specifike 1,22 Kg/lKonsumi teorik: 3-5 kg/m²Djegshmëria: i padjegshëmRëshkitja horizontale ≤ 0,5 mm Rezistenca në shkëputje 1,5 N/mm². Produkti duhet te përmbushë specifikimet teknike në përputhje me Standardin Shqiptar

SSH EN 12004:2007 +A1:2012 ose ekuivalente Duhet te paraqiten:Kataloget/skedat teknike te shoqeruara me Çertifikatë Konfirmiteti CE/Deklarata Performance leshuar nga prodhuesi

Pllakë shtrimi grez porcelanato. Format 60/60 cm x 10mm, Porcelain . Nuk duhet të jenë të lëmuara në mënyrë që të shmanget rrëshqitja. Duhet të jenë rezistente ndaj gërvishtjeve (kategoria 4) dhe të kenë koeficientin më të lartë të mundshëm kundër rrëshqitjes Duhet te paraqiten:Kataloget/skedat teknike te shoqeruara me Çertifikatë Konfirmiteti CE/Deklarata Performance leshuar nga prodhuesi

Veshje me pllakë majolike, Format 30x60 cm x 10mm ose 60x60 (mbas kërkesës), Porcelain ,cilësi e parë. Duhet te paraqiten:Kataloget/skedat teknike te shoqeruara me Çertifikatë Konfirmiteti CE/Deklarata Performance leshuar nga prodhuesi

Parket Dru per mbulimin e dyshemese (palestra), per perdorim te brendshem. Produkti duhet te përmbushë specifikimet teknike në përputhje me Standardin SSH: EN ISO 14342:2013 ose ekuivalente, Duhet te paraqiten:Kataloget/skedat teknike te shoqeruara me Çertifikatë Konfirmiteti CE/Deklarata Performance leshuar nga prodhuesi

PUNIME SUVATIMI DHE VESHJE

Suva (Llac mbushës)- Produkti duhet te përmbushë specifikimet teknike në përputhje me Standardin SSH: EN 998-1 ose ekuivalente. Në rast se është produkt jo i gatshëm të deklarohet receptura përkatëse që vërteton se produkti përmbush specifikimet teknike te kerkuara edhe sipas SSH: EN 998-1 ose ekuivalente. Duhet te paraqiten:Kataloget/skedat teknike te shoqeruara me raportet e testimit nga laboratore te akredituar me ISO 17025 ose ekuivalente

Fino Produkti duhet te përmbushë specifikimet teknike te kerkuara edhe në përputhje me Standardin SSH: EN 998-1 ose ekuivalente. Duhet te paraqiten:Kataloget/skedat teknike te shoqeruara me raportet e testimit nga laboratore te akredituar me ISO 17025 ose ekuivalente

Sistem Kapote Produkti duhet te përmbushë specifikimet teknike te kerkuara edhe në përputhje me Standardin SSH: EN 13499 ose ekuivalent. Duhet te paraqiten:Kataloget/skedat teknike te produkteve perberese te sistemit e shoqeruar me Certificate Cilesise nga laboratore te akredituar me ISO 17025 ose ekuivalente

PUNIME HIDRAULIKE

Tuba PPR Tubat PPR duhet te jene te perbera prej materiali cilesor polipropileni si dhe me perberje polimeri (kopolimer) . Duhet te kene aftesi te mira te ruatjes se formes se tyre ndaj faktoreve te cilet ndikojne ne ndryshimet sasore dhe vetite e materialit si fleksibiliteti dhe fluiditeti .Tubat duhet te jene te prodhuara sipas EN ISO 15874-3 ose ekuivalente dhe te afta per te perballuar presione deri ne 25 bar ose 2.5 MPa. Dendesia e materialit Sipas standartit :ISO 1183 ose ekuivalente. Elasticiteti I tubit sipas:ISO 527-2/1 ose ekuivalente. Fortesia e tubit sipas :ISO 865 ose ekuivalente. Rezistenca ndaj goditjeve sipas:ISO 179 ose ekuivalente. Percueshmeria termike sipas:DIN 52612 ose ekuivalente. Tubat PP-R duhet te jene te pershtatshem per tu perdorur ne linjat e ujit te pijshem dhe te jene te certikuar me certificate aprovimi te leshuar nga Institucion Nderkombetar ose Kombetar per perdorimin ne linjat e ujit te pijshem (p.sh DVGW). Duhet te paraqiten: Kataloget/ skedat teknike te shoqeruara me Çertifikatë Konfirmiteti CE/Deklarata Performance leshuar nga prodhuesi

Tuba PVC-U Tubat pvc duhet te jene nga material pvc (klorur polivinil) me veti te mira mekanike me rezistence te larte dhe material shume i lehte per sisitemet e kanalizimeve sipas standartit EN13476 ose ekuivalente. Tubat pvc duhet te jete me tre shtresa (shtrese e jashtme e lemuar, shtrese e brendshme e lemuar dhe shtrese me shkume klorur polivinil), ku shtresa e brendshme te kete vrazhdesi te ulet dhe perfomace te mire hidraulike e,rezistence te larte ndaj grryerjes dhe antibakteriale.rezistente ndaj korrozionit ne mjedise alkaline, acide ose agresive dhe me jete gjatesi mbi 50 vjet.te kete qendrushmeri te larte termike dhe rezistente ndaj

ngarkesave te vazhdueshme termike deri ne 40°C. Shtresa e brendshme duhet te jete nga klorur polivinil i perfocuar me mbushes mineral e cila i jep tubit force dhe fleksibilitet. Shtresa e jashtme duhet te jete nga klorur polivinili portokalli e cila mundeson rezistence me te mire ndaj goditjes gjate trajtimit te instalimit te tubit. Tubat PVC jane te lire dhe te shpejte ne montimi duke lidhur skajet e tubave me bashkues. Transportimi I tyre behet ne menyre te thjeshte dhe te lehte. Unaza mbyllëse gome EPDM sipas EN 681 ose ekuivalente. Materiali: PVC. Struktura e tubit: me tre shtresa ose me nje shtrese. Densiteti: shtrese e lemuar $\geq 1.42-1.48 \text{ g/cm}^3$ Shtresa e shkumes $= 0.8-1 \text{ g/cm}^3$ Rezistenca e temperatures: 40-60°C, ku afatshkurter deri ne 60 °C dhe afatgjate deri ne 40 °C Zgjatimi linear Koeficient : $5 \times 10^{-5} \text{ mm/mm}^\circ\text{C}$ Rezistenca kimike: pH 2-12 Menyra e lidhjes: Prizë dhe unazë gome - rezistente ndaj rrjedhjeve deri ne presion 0.5 bar Elasticiteti: 2.7-3.3 GPa Klasifikimi zjarrit: B2 ndezshmeri normale Fusha e aplikimit: varrosur brenda strukturese se ndertesese dhe jashte strukturese se ndertesese. Tuba PVC duhet te jene te certifikuar nga nje insitucion Nderkombetar ose Kombetar i akredituar e cila te vertetoj qe tubat PVC me tre shtresa jane te certrifikuara dhe i plotesojne te gjitha parametrat per kanalizimet e jashtme. Duhet te paraqiten: Kataloget/ skedat teknike te shoqeruara me Çertifikatë Konfirmiteti CE/Deklarata Performance leshuar nga prodhuesi

PUNIME HIDROSANITARE

Boljer Ngrohësit e ujit duhet te jene te pershtatshem per te plotesuar e gjitha kerkesat per ujin e ngrohëte te mundesojne instalimin e tyre kudo horizontal dhe vertikal me nje rryme 220-240 V AC .Shtresa e jashte te jete abs e forte dhe rezistenca e ngrohjes se ujit celik inoxi Klasa ERP:CI pajisur me valvul presioni deri ne 6 bar, tregues te nivelit te temperatures, tregues I drites ndezje/fikje, regjistrim manual I temperatures. Duhet te paraqiten: Kataloget/ skedat teknike te shoqeruara me Çertifikatë Konfirmiteti CE/Deklarata Performance leshuar nga prodhuesi

Lavaman Lavamani ngjyre e bardhe. Materiali porcelan. Te jete me lartesi 800-900mm. Te kete gjerësi maksimalisht 600mm dhe gjatesi minimalisht 650mm. Pjesa e montimit te behet me ane te dy vrimave me largësi 280mm. .Lavamanet duhet te permbushin kerkesat funksionale ,rezistenca e ngarkesese, pastrueshmeria, qendrueshmeria shkalla e rrjedhjes sipas normes EN 14688 ose ekuivalente Duhet te paraqiten: Kataloget/ skedat teknike te shoqeruara me Çertifikatë Konfirmiteti CE/Deklarata Performance leshuar nga prodhuesi

WC WC duhet te jete e perbere prej porcelani cilesor. Materiali duhet te jete rezistent ndaj gershitjeve. Lartesia te jete nga 50- 70 cm , gjerësia te jete 30-40 cm. WC duhet te permbushin kerkesat funksionale dhe metodat e testimit sipas standartit EN 997 2012 ,rezistencen e ngarkesese, pastrueshmerin, qendrueshmerin shkallen e rrjedhjes sipas normes EN 997 2012 ose ekuivalente Duhet te paraqiten: Kataloget/ skedat teknike te shoqeruara me Çertifikatë Konfirmiteti CE/Deklarata Performance leshuar nga prodhuesi

Grupi Lavamani Grupi I lavamanit mishelator duhet te jete i perbere prej materiali metalik dhe me shtrese inoksi kunder fenomenit te ndryshkjes. Ne perberjen e tij duhet te kete te inkorporuar mekanizmin e unifikuuar apo valvulen e kontrollit me hapje tip “sfere” ku te behet e mundur plotesimi I nevojave sipas kerkesese me uje te ngrohëte apo te ftohte. Grupi lavamanit ne pjesen e rubinetit duhet te jete I pajisur me filter te cilesise te larte ku te bllokoje cdo papasterti te mundshme qe vjen si pasoje se furnizimit me uje nga linjat kryesore te shperndarjes. Mishelatori duhet te jete konform me standardin EN 817 ose ekuivalent. Duhet te paraqiten: Kataloget/ skedat teknike te shoqeruara me Çertifikatë Konfirmiteti CE/Deklarata Performance leshuar nga prodhuesi

Tavoline e vogel, per drejtuesit e keshillit Syprina melaminë me trashësi 2.5 cm. Veshje laminati me rezistencë të lartë kundër gërvishtjeve dhe njollave. Këmbët janë me plane të të njëjtit material dhe trashësi të syprinës. Bordet anësore të planit të punës dhe të këmbëve të jenë të rrethuara me material plastik PVC. Bashkimi i planit të punës

(syprinës) me këmbët bëhet në mënyrë të tillë që i jep tavolinës pamje solide. Aksesorët që përdoren për montimin e elementëve të tavolinës të jenë cilësorë. Këmbët të jenë me mekanizëm nivelues. Syprina e tavolinës përbëhet nga 4 elementë. Dy elementë me përmasa 180 x 80 cm që vendosen paralelisht me njëri tjetrin duke lënë një hapësirë 10 cm midis tyre. Dy elementët e tjerë janë në përmasa 170 x 85 cm, dhe janë në formë gjysmërrethi. Duke u vendosur përballë njëra tjetrës, në dy anët e ngushta të dy elementëve të parë i japin tavolinës një pamje ovale. Të plotësojë kërkesat e standartit SSH EN 527-1:2011, SSH EN 527- 2:2016 + A1:2019 (EN, e njëvlefshme ose e përditësuar), SSH EN 13721:2004

Karrige statike, për të ftuarit Karriget të jenë dizenuar me një stil modern. Thellësia e ulëses e përshtatshme për përdorues të rritur. Skeleti përbëhet prej një tubi petashuq ovale 30 x 15 mm me spesor jo më të vogël se 1.3 mm, i cili përshkon shpinoren në dy anët e saj dhe ndenjësën. Montohen në skeletin metalik me vida. Me mbushje gome sintetike me densitet të lartë. Lyerja me boje elektrostatische. Tapiceria të jetë lëkurë ekologjike. Ngjyra do të percaktohet në momentin nënshkrimit të kontratës. Karrigia duhet të plotësojë kërkesat e standardit SSH EN 1729-1:2015, SSH EN 1729-2:2012+A1:2015, (e njëvlefshme ose e përditësuar)

Karrige rrotulluese me rrota Me tapiceri prej lëkure ekologjike, me shpinore të lartë. Me një mekanizëm që lejon fiksimin e pozicioneve të ndryshme të përshtatshme në ulje. Shpinorja duhet të jetë e përshtatshme në pozicionet vertikalisht si dhe para e prapa. Duhet të ketë krahë anësore. Të ketë përshtatëse piston me gaz për nivelimin e lartësisë. Thellësia e ulëses e përshtatshme për përdorues të rritur. Bazamenti duhet të jetë metalik ose plastik me 5 degëzime në formë ylli dhe me rrota sferike në ekstremet e tyre. Karrigia duhet të plotësojë kërkesat e standardit EN 1335-1:2020+A1:2022; EN 1335-2:2018 dhe SSH EN 12529:1998 (e njëvlefshme dhe e përditësuar)

2.3.12 Operatori/et ekonomik duhet të paraqesin certifikatat e cilësisë së punimeve, për objektin që prokurohet, të cilat duhet të jenë të perkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuara, sipas standardeve:

- Çertifikatat e cilësisë sipas Standartit **ISO 9001:2015 (për sistemin e menaxhimit të cilësisë)**, e vlefshme,
- Çertifikatat e cilësisë sipas Standartit **ISO 14001:2015 (për sistemin e menaxhimit të mjedisit)**, e vlefshme,
- Çertifikatat e cilësisë sipas Standartit **ISO 45001:2018 (për sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë)**, ose certifikatën ekuivalente, e vlefshme,

Ne rastin e bashkimit të perkohshëm të shoqërive secili operator duhet të paraqesë certifikatat e mesiperme, në varesi të punimeve që do të marrin për konformitet me marrëveshjet.

Të gjitha certifikatat e mësipërme duhet të jenë të vlefshme të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

2.3.13 Operatori ekonomik duhet të ketë në dispozicion apo mund t'i vihen në dispozicion mjetet e pajisjet teknike të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, si me poshtë (sipas formularit përmbledhës të vetedeklarimit):

<i>Mjetet</i>	<i>Sasia</i>	<i>Gjendja</i>
Kamion veteshkarkues (kapaciteti mbajtës <u>minimum 10 - 12 ton</u>)	1 copë	Pronësi ose me qera
Kamioncine (kapaciteti mbajtës deri ne 3.5-5 ton)	1 copë	Pronësi ose me qera
Kamion me vinc kapacitet mbajtes 3.5 - 7 ton	1 copë	Pronësi ose me qera
Autovinc	1 copë	Pronësi ose me qera
Autobetoniere 2.5-3.5 m3	1 copë	Pronësi ose me qera
Autopompe betoni	1 copë	Pronësi ose me qera
Eskavator me Goma (Mjet teknologjik me Goma)	1 copë	Pronësi ose me qera
Minieskavator	1 copë	Pronësi ose me qera
Vinc Karrel	1 copë	Pronësi ose me qera
Betoniere kantieri	2 copë	Pronësi ose me qera
Vibrator betoni	2 copë	Pronësi ose me qera
Trapano	1 copë	Pronësi ose me qera
Elektroorgano	1 copë	Pronësi ose me qera
Elektrosaldatriçe	1 copë	Pronësi ose me qera
Gazogjen	1 copë	Pronësi ose me qera
Skeleri fasade	1000m2	Pronësi ose me qera
Autobot Uji	1 cope	Pronësi ose me qera

Të paraqiten mjete dhe pajisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit si më poshtë:

- Kokore minimumi 40 copë
- Fikëse zjarri të lëvizshme me kapacitet 5-7 litra secila minimumi 2 copë
- Komplet i ndihmës së shpejtë minimumi 4 copë
- Uniforma/Jelek pune 40 cope
- Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi 10 copë

a) Për mjetet në pronësi duhet të paraqitet: a) dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (akti i pronësisë); b) leje qarkullimi; c) certifikate e kontrollit teknik (e vlefshme); d) siguracion mjeti (i vlefshëm); e) certifikatë për transport mallrash brenda vendit (e vlefshme).

b) Për mjetet e deklaruar me qera duhet të paraqitet a) dokumenti që verteton regjistrimin e tij (akti i pronësisë) b) leje qarkullimi; c) certifikaten e kontrollit teknik (e vlefshme) ç) siguracion mjeti (i vlefshëm); d) certifikatë për transport mallrash brenda vendit per te trete dhe me qera (e vlefshme).

c) Për pajisjet teknike, të cilat janë në pronësi të operatorit ekonomik, duhet të paraqitet kontrata e shitblerjes/fatura tatimore e shitjes ndërsa kur janë të marra me qera duhet të paraqitet kontrata e qerasë, fatura tatimore e shitjes/ kontrata e shitblerjes. Në rastin kur fatura është lëshuar nga subjekte që nuk janë të regjistruar si tatimpagues të TVSH-së duhet të shoqërohet me kuponin tatimor.

d) Për mjetet dhe pajisjet teknike që ka deklaruar operatori ekonomik duhet të paraqesë foto të qarta për secilin mjet dhe pajisje. Në rastin e mjeteve të targuara duhet të jetë e dukshme ne nje foto te vetme mjeti dhe targa e tij.

e) Per impantin e betonit te paraqiten leje mjedisore, certificate kalibrimi dhe te jete ne vendodhje jo me larg se dy ore nga objekti i prokurimit ne perputhje me VKM Nr.679 date 22.10.2004.

- Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë me anë të së cilës pranon verifikimin e mjeteve dhe pajisjeve të deklaruar në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës nga Autoriteti Kontraktor.
- Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës deklaron se mjetet dhe pajisjet e deklaruar nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk janë të deklaruar ne procedurat te shpallura fitues.
- Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë për vendndodhjen e mjeteve ne pronesi ose me qera me qellim verifikimi nga Autoriteti Kontraktor.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

